

# INVESTIMI NË RRITJEN E VLERAVE DEMOKRATIKE



## NXËNËSIT INFORMOHEN PËR KUVENDIN

MUSLI (10), LEONITA (10), ERZA (10), ERION (10), ZANA (10), URATA (10), ARLINDA (10), LEONIT (10)



### Ndryshimi fillon nga qytetarët të cilët janë të angazhuar në progresin e vazhdueshëm të shtetit demokratik

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është faktor përcaktues në zhvillimin e një shteti demokratik. Themi kështu duke u bazuar në faktin se përzgjedhja që e bëjnë qytetarët, ndikon në tërë zhvillimin e shtetit. Këtë mund ta shohim edhe ne, sepse jetojmë në një



Të gjithë kemi filluar të ngjyrosemi me vlerat e demokracisë


shtet demokratik, siç është Kosova. Shteti ynë ka Kuvendin si institucion që sjell harmoni dhe barazi në vend. Kjo dëshmohet nga krijimi i ligjeve, ku të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Një ligj i tillë është edhe ligji për arsimin, ku të gjithë qytetarët parashihet të kenë qasje në institucionet shkollore. Prandaj, ka edhe iniciativa të ndryshme që theksojnë rëndësinë e përfshirjes së të gjithë fëmijëve

në sistemin edukativo-arsimor. Për shembull, në këtë javë në Kosovë po shënohet java „Kundër braktisjes së shkollimit“. Për këtë, janë përgatitur dhe janë duke u realizuar shumë aktivitete për të parandaluar këtë fenomen që është shqetësues për popullin. Kjo po bëhet meqenëse arsimimi dhe edukimi i të gjithëve pa asnjë dallim është i rregulluar edhe me ligj, ashtu siç e përmendëm. Ligjet miratohen në Kuvend. Normalisht se edukimi i qytetarëve është në interes të shtetit, sepse ngritja e kapaciteteve intelektuale sjell ndryshime pozitive në vend. Prandaj, Kuvendi i ka dhënë rëndësi të veçantë këtij aspekti. Kur kemi njohuri, dijmë të bëjmë vlerësime të duhura. Vlerësimi i mirë ndikon edhe në përzgjedhje të mirë. Andaj, nga të gjithë qytetarët kërkohet që të informohen sa më shumë dhe të bëjnë përzgjedhjen më të mirë për kandidatët për deputetë, të cilët do të jenë përfaqësuesit e vendit. Popull i dashur, fuqinë e kemi në duart tona. Ne kemi vlerë.



Sot do ta vizitojmë Kuvendin tonë të dashur

Më poshtë mund të gjeni disa vizatime të realizuara gjatë Punëtorisë së Demokracisë „Demos-ti“. Ne jemi shumë të kënaqur që jemi pjesë e kësaj Punëtorie, ku kemi marrë aq shumë informata që do të na përgatisin për të ardhmen. Për t’u informuar edhe më shumë se çka kemi mësuar, lexoni përshkrimet e vizatimeve




Këtu kemi paraqitur një fytyrë të lumtur, për arsye se të mësosh se cili është kontributi yt në demokraci me të vërtetë që të bën të ndjehesh mirë

Ndonëse kemi qenë të ndarë në grupe, në këtë faqe janë paraqitur të gjitha vizatimet tona.

Të qenurit gazetarë na ka bërë të ndihemi shumë mirë, por edhe shumë të rëndësishëm. Gjithashtu, kemi kuptuar se përgjegjësitë në jetë vetëm sa ndikojnë për mirë në rritjen tonë, si fëmijë. Themi kështu, sepse kur kemi ardhur këtu në Punëtori nuk e kemi ditur se jemi

të zotë të shkruajmë një gazetë të tërë vetëm për katër orë. Mirëpo, me punë dhe me përkushtim arrihen të gjitha. Sot, përgjegjësia që na është dhënë si gazetarë na ka bërë të kuptojmë se kur duam diçka e arrijmë. Kuptohet me punë dhe përkushtim. Ne iu falenderojmë që ju po e lexoni gazetën tonë. Shpresojmë që jeni informuar rreth demokracisë dhe temave të tjera.



Ashtu siç rritet trunghi, ashtu po rritet edhe demokracia




Media, mjet informimi në demokraci

## E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR

LEONIT (10), ARI (10), ARJETA (10), HANA (10), DONJETA (10), MERITA (10), ELMEDINA (10),

ELSA (10)



**Në demokraci ne fëmijët kemi të drejtë të zgjedhim gjërat që neve na pëlqejnë. Nëse dëshironi të dini më shumë për këtë, lexojeni artikullin**

Unë jam Arjeta, jam 10 vjeçare dhe vijoj mësimet në shkollën fillore „Andon Zako Çajupi“. Ishte ditë e martë dhe u nisa për në shkollë. Pas 4 orëve mësimore filloi ora e edukatës fizike. E gjithë klasa patëm mundësinë të zgjedhim lojën të cilën do ta luanim. Lojërat të cilat neve na pëlqyen më shumë ishin kukafshehtas dhe basketbolli. Pasi që nuk mjaftonte koha për të dyja lojërat, ne nxënësit e klasës morëm mendimin dhe pëlqimin e të gjithëve dhe vendosëm për lojën të cilën dëshironim të luanim. Loja që na pëlqeu më shumë ishte kukafshehtas. Kjo do të thotë që të gjithë fëmijët e kemi të drejtën për të zgjedhur aktivitetin apo lojën që ne dëshirojmë ta zhvillojmë. Përveç kësaj të drejte, ne kemi edhe shumë të drejta tjera ,të cilat janë: e drejta e familjes, e drejta e streh-

imit, e drejta e shkollimit, etj. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj në demokraci.

Mirëpo, në zgjedhjet lokale dhe qendrore të cilat zhvillohen në shtetin tonë, ne nuk kemi të drejtë të votojmë, sepse ende jemi të mitur dhe nuk jemi të pjekur aq sa duhet për të marrë vendime, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Mosha prej së cilës ne do të kemi të drejtën për të votuar në procesin zgjedhor është mosha 18 vjeçare. Kur të rritemi ne do të votojmë, sepse vota bën ndryshimin.



**Në demokraci, fëmijët e kanë të drejtën e lojës**



**Grupi „Inteligjëtët“**

# E DREJTA E INFORMIMIT TË SAKTË

ERISA (10), OLEAND (11), MIRJETA (10), DIART (10), ELSA (10), UNELS (10), AURORA (10)



## Roli i medias është shumë i rëndësishëm, sepse përmes saj, ne informohemi për gjithçka që neve na intereson të dijmë

Ne nxënësit e klasës V-1 nga shkolla „Andon Zako Çajupi“, nga qyteti i Vushtrrisë, e kemi shumë të theksuar kureshtjen. Kur na informoi mësuesja se ne do të marrim pjesë në një Punëtori të Demokracisë, atëherë neve na erdhi një ide e veçantë. Ne hulumtuam në internet, sepse dëshironim të dinim më shumë për demokracinë. Mësuam çfarë është demokracia, si funksionon demokracia, kur ka lindur ajo e shumë e shumë gjëra të tjera interesante.

Ne e pritëm me padurim ardhjen në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“. Këtu i përforcuar njohuritë tona që i kishim. Gjithashtu, mësuam më shumë për informimin e qytetarëve në demokraci. E gjithë kjo u realizua me ndihmën e edukatores Bjondinë.

Më parë, në kohët e lashta, qytetarët nuk kanë pasur shumë mënyra të mira për t'u informuar. Kjo ka ndodhur përmes gdhendjes së gurëve, drunjëve, murëve, etj. Pastaj, për t'i informuar qytetarët e tjerë se ka rrezik në një zonë të caktuar, ata ndiznin zjarr dhe lajmëronin të tjerët me tym, e kështu me radhë.

Mirëpo, sot informimi, hulumtimi në internet dhe komunikimi, mundësohen nga media. Media është çdo mjet informues, me anë të së cilës qytetarët i marrin informatat e nevojshme, qoftë për atë se çfarë ndodh brenda shtetit, qoftë për atë që ndodh në botë.

Ekzistojnë dy lloje të medias: të shkruara të cilat janë: lektyrat, romanet, gazetat, revistat, etj.; si dhe ato elektronike: telefoni, kompjuteri, televizioni, radio, etj. Sot u kënaqëm shumë me çdo gjë që na u është ofruar në këtë Punëtori. Por, më shumë u kënaqëm me informatat të cilat i morëm, sepse nga e gjithë kjo kuptuam se media ka një rëndësi të madhe në demokraci. Pa median, ne nuk do të ishim përgatitur paraprakisht për këtë Punëtori dhe nuk do të dinim se një projekt i tillë si „Demos-ti“ ekziston në Kosovë.

Me anë të medias, ne gjithashtu do të kemi mundësi ta shohim gazetën tonë në web-faqe, ku do të publikohet online pas një kohe.

Ne urojmë që të gjithë fëmijët të përjetojnë një ndjenjë të tillë, sepse vërtet sot jemi ndjerë mirë.





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Andon Zako Çajupi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri